

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës
Nr. 02-63/24-07
Prishtinë, më 30 tetor dhe 2 nëntor 2007
Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi **Kolë BERISHA**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Nailm Maloku**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari hapi seancën dhe konstatoi se janë të pranishëm 79 deputetë.

Kryetari i njoftoi deputetët e pranishëm se Kryesia e Kuvendit, pas konsultimit me kryetarët e grupeve parlamentare, në bazë të rregullave 6 dhe 23 të Rregullores së Punës të Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka propozuar rendin e ditës për seancën e sotme. Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 25 tetor 2007, ka diskutuar lidhur me aktivitetin e Kuvendit gjatë fushatës zgjedhore. Sipas rregullës 5.2 të Rregullores së Punës, Kuvendi pezullon punën nga dita e fillimit të fushatës zgjedhore. Meqë gjatë kësaj periudhe janë duke u zhvilluar bisedimet për zgjidhjen e statusit të Kosovës, Kuvendi i Kosovës duhet të jetë i gatshëm, në çfarëdo rrethanash, për të marrë vendime valide dhe të pakontestueshme për të ardhmen e vendit. Gjithashtu, Kuvendi duhet ta zhvillojë aktivitetin ligjvënës, me qëllim të përmbushjes së strategjisë legislative të këtij mandati.

Duke u mbështetur në arsyet e cekura më lart Kryesia i propozon Kuvendit të marrë vendim për shmangie të përkohshme të Rregullës 5.2 të Rregullores së Punës.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e Kryesisë. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----55, (53 vota përmes votimit elektronik dhe 2 vota me ngritje dore),
Kundër----- 1.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, mori

V E N D I M

Për shmangie të përkohshme të rregullës 5. 2 të Rregullores së Punë të Kuvendit të Kosovës në mënyrë që të vazhdojë punën e tij të rregullt deri në certifikimin e deputetëve të legjislaturës së ardhshme të Kuvendit të Kosovës.

Në vazhdim të procedimit me miratim të rendit të ditës, Alush Gashi, kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së tha se në konsultim me kryetarët e grupeve të tjera parlamentare janë pajtuar që Kuvendi, gjatë fushatës zgjedhore, të mos diskutojë për pikën e përhershme për pyetje parlamentare dhe përgjigje të Qeverisë.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të LDK-së. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për41 (39 në mënyrë elektronike dhe 2 me ngritje dore),
Kundër8.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, vendosi që pika e tretë – Koha për pyetje parlamentare dhe përgjigje të Qeverisë - të hiqet nga rendi i ditës së kësaj seance.

Jakup Krasiniqi, kryetar i Grupit Parlamentar të PDK-së propozoi që pika e katërt - Debat lidhur me ofertën për Traktatin e Miqësisë dhe të Bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, të hiqet nga rendi i ditës duke kërkuar nga Grupi i Unitetit që ta informojë Kuvendin pas përfundimit të bisedimeve 120-ditëshe.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të PDK-së. Rezultati i votimit ishte si vijon :

Për55 (53 në mënyrë elektronike dhe 2 me ngritje dore),
Kundër4.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, miratoi propozimin që pika e katërt të hiqet nga rendi i ditës.

Në vazhdim, **Kryetari** i njoftoi deputetët me shkresën e shefit të OSBE-së, në të cilën ai kishte paraqitur shqetësimin lidhur me procesin e zgjedhjes së Avokatit të Popullit. Me anë të kësaj shkrese i është sugjeruar Kuvendit që ta rishikojë procesin e tanishëm të përzgjedhjes së tre (3) kandidatëve për pozitën e Avokatit të Popullit dhe të iniciohet një proces i ri i përzgjedhjes ku duhet të merren në konsiderim të gjithë kandidatët që kanë aplikuar, në përbërje të plotë të komisionit intervistues dhe prezencës së shoqërisë civile.

Kryetari e hodhi në votim për propozimin heqjen e pikës së 12-të nga rendi i ditës. Rezultati i votimit ishte si vijon :

Për48 (46 në mënyrë elektronike dhe 2 me ngritje dore),
Kundër22.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese dhe të Panelit Intervistues për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, hiqet nga rendi i ditës, përkatësisht shtyhet për shqyrtim në njërën nga seancat e radhës së Kuvendit.

Ngarkohet Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese dhe Paneli Intervistues që t'i riintervistojë të gjithë aplikuesit për pozitën e Avokatit të Popullit, në praninë e përfaqësuesve të Shoqërisë Civile, në pajtim me vërejtjet e OSBE-së, të Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë dhe të Zyrës së Komisarit të Lartë të OKB-së për të Drejta e Njeriut në Kosovë.

Pastaj, seanca i zhvilloi punimet me këtë

R E N D I T E

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 18 tetorit 2007,
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për hetim parlamentar,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekusore.
8. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport lidhur me Projektligjin për arsimin dhe aftësimin privat,
9. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për kthim në ripunim të Projektligjit për punë, të Projektligjit për grevat dhe të Projektligjit për organizimin sindikal.
10. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 18 tetorit 2007

Procesverbali i seancës plenare të 18 tetorit 2007 u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për hetim parlamentar

Kryetari e ftoi propozuesin ta arsyetojë këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Deputeti **Hydajet Hyseni**, në emër të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, arsyetoi para deputetëve të Kuvendit nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim, deputeti **Hyseni** arsyetoi: qëllimin, objektivat, materien që e rregullon Projektligji për hetim parlamentar, i radhitur në gjashtë kapituj dhe në njëzetepesë nene, si dhe mënyrën e zbatimit të tij.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ana e deputetit **Hyseni**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Sadudin Berisha**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Gjylnaze Syla**, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, **Gazmend Muhaxheri**, në emër të Grupit Parlamentar 6+, **Mahir Yagcilar**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Ramadan Kelmendi** dhe në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, **Gjergj Dedaj**, të cilat iu janë bashkangjitur trasnkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 52;

Kundër----- 0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës njëzëri miratoi, në parim, Projektligjin për hetim parlamentar.

Kuvendi ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese – si Komision Përgjegjës dhe Raportues - për ta shqyrtuar këtë projektligj brenda afatit të paraparë me Rregullore të punës dhe për t'ia paraqitur Kuvendit raportin me rekomandime.

Pas kësaj kohe seancën e kryesoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës dhe Raportues.

Ai i hodhi në votim , veç e veç, amendamentet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30 dhe 31.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----65;

Kundër----- 0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës miratoi njëzëri Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për të drejtat dhe përgjegjësit e deputetit

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të Projektligjit për të drejtat dhe përgjegjësit e deputetit, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës dhe Raportues.

Ai i hodhi në votim , veç e veç, amendamentet e Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, të deputetit Ramadan Kelmendi, të deputetit Behxhet Brajshori, të deputetit Hydajet Hyseni dhe të deputetes Gjylnaze Syla.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1 dhe 3.

Në mungesë të kuorumit, kryesuesi seancën e sotme e deklaroi të mbyllur 12 :20 minuta.

E premte, 2 nëntor 2007

VAZHDIM I SEANCËS

Seancën e kryesoi **Kolë BERISHA**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 62 deputetë (më vonë në seancë ishin të pranishëm 71 deputetë) dhe vazhdoi shqyrtimin e dytë të Projektligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit, përkatësisht me procedimin e votimit të amendamenteve, një nga një.

Kuvendi miratoi amendamentet:4, 5, 6(a), 7, 8, 9, 10, 12, 14,(me riformulimin e Sabri Hamitit), dhe 20.

Kuvendi nuk i miratoi këto amendamente: 2, 11, 13, 21 dhe 22, kurse amendamentet 15, 16, 17, 18 dhe 19 i tërhoqi propozuesi Hydahet Hyseni.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----65;

Kundër----- 6.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës miratoi, me shumicë votash, Ligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

Kryetari informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës dhe Raportues.

Ai i hodhi në votim , veç e veç, amendamentet e Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media lidhur me Projektligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----56;

Kundër----- 0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës miratoi njëzëri Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekusore

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të Projektligjit për barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekusore, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës dhe Raportues.

Ai i hodhi në votim , veç e veç, amendamentet e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale lidhur me Projektligjin për barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekusore.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45 dhe 46.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----63;

Kundër----- 0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës miratoi njëzëri Ligjin për barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekusore.

7. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport lidhur me Projektligjin për arsimin dhe aftësimin privat

Kuvendi, pasi shqyrtoi Rekomandimin e Komisionit të cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

Projektligji për arsimin dhe aftësimin privat i kthehet për ripunim propozuesit – Qeverisë së Kosovës.

8. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale lidhur me procedimin e Projektligjit për punë, të Projektligjit për grevat dhe të Projektligjit për organizimin sindikal

Kuvendi, pasi shqyrtoi Rekomandimin e Komisionit të cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

Projektligji për punë, Projektligji për grevat dhe Projektligji për organizimin sindikal i kthehet për ripunim propozuesit – Qeverisë së Kosovës.

9. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore

Kuvendi, pasi e shqyrtoi Rekomandimin e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport për emërimin e anëtarëve të Këshillit për Trashëgiminë Kulturore, mori këtë

V E N D I M

1. Anëtarë të Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore emërohen:

1. Nimon Alimusaj, anëtar,
2. Edi Shukriu, anëtar,
3. Fejaz Drançolli, anëtar,
4. Tahir Emra, anëtar,
5. Zymer Neziri, anëtar,
6. Branisllav Grbiq, anëtar dhe
7. Enis Kervan, anëtar.

2. Mandati i anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore zgjatë tri (3) vjet.

Kryetari seancën e deklaroi të mbyllur në orën 11: 15 minuta.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Kolë Berisha

E hartoi: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**